REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 503/20
Datë/Datum. 27/07/20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ANKESË

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për:Organin Shqyrtues të Prokurimit

*Për aktivitetin e prokurimit:" **Ngritja e pemishteve me arrë dhe lajthi në Komunën e Prizrenit**"*

*Numri i aktivitetit të prokurimit: **622-20-2025-5-2-1***

*Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK : **"ECO FRUITS" shpk***

Pn Batllave Podujeve *11000*
(Vendi) *(Kodi postar)*

(Numri Telefonit)) 044170090 *(Numri i Faks-it)*

Salih Statovci
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

(Adresa elektronike) ecofruitsprodocts@gmail.com

24.07.2020
(Data e parashtrimit të kërkesës)

ECO FRUITS
(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

-Njoftimi pér kontrat I publikuar me daté 15.05.2020
-Afati I fundit perdorzim ka qené 03.06.2020 dhe të njejtën ditë është bërë hapja e ofertave,,
-Kriter për dhënie e kontratës tenderi i përgjegjshëm me qmim më të ulët
-Letra standarde për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit 08.07.2020,
-Kërkesa për ri-shqyrtim me dt.13.07.2020,
-Vendimi mbi refuzim të kërkesës për ri-shqyrtim me dt.15.07.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [x] **Jo** [ ]

Nga AK-Komuna e Prizrenit kemi pranuar vendimin mbi refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim lidhur me aktiviteti i prokurimit: " Ngritja e pemishteve me arrë dhe lajthi në Komunen e Prizrenit"me nr.të prokurimit 622-20-2025-5-2-1 me arsyetimin se gjatë vlerësimit kemi patur parasysh të gjitha kërkesat e DT dhe NJPK dhe kemi pasur parasysh nenin 1 të LPP.
Bazuar në dispozitat e nenit 109 të LPP parashtrojm ankesë kundër vendimit mbi refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim lidhur me aktiviteti i prokurimit: " ***Ngritja e pemishteve me arrë dhe lajthi në Komunen e Prizrenit"me nr.të prokurimit 622-20-2025-5-2-1.***
Nga AK kemi pranuar vendimin mbi refuzimi e kërkesës për ri-shqyrtim me dt.15.07.2020.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK me këtë rast ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP dhe atë të neneve si më poshtë:
Neni 1,
Nenit 7,
Nenit 56.3,
Nenit 59,
Nenit 72,
Nenin 108A,

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Refuzimi i kërkesës për ri-shqyrtim nga ana e AK-Komuna e Prizrenit nuk përket me pretendimet tona ankimore të parashtruar në kërkesën për ri-shqyrtim,arsyetimi i dhënë në këtë vendim vetëm me një paragraf është jo profesional dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 47 dhe 48 të Ligjit të Përgjithshëm për Procedurë Administrative,sepse AK ka qenë i detyruar të jep arsyetim se pse nuk qëndrojn pretendimet tona ankimore.
Në kërkesën tonë për ri-shqyrtim kemi kontestuar qarkullimin e kërkuar për natyrën e kontratë e po ashtu edhe kontratat dhe referencat e kërkuara që OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka dorëzuar gjatë ofertimit por as gjatë kërkesës së AK me rastin e sqarime sipas nenit 72 të LPP-së.
Në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë kemi gjetur se i njejti ka dorëzuar një kontratë dhe referencë e cila pas sqarime ka ndryshuar në përmbajtje dhe emërim.
Në platformën elektonike të e-prokurimit me rastin e ofertimit OE i rekomanduar për kontratë "Agrium"SHPK në platformën e e-prokurimit ka ofertuar me referenc dhe kontratë të lidhur me kompanin "EOS"SHPK nga Gjilani për furnizim të fidaneve të arrës nga BE në këtë kontratë është shënuar se objekt i kontratës është ***"Shit-blerja e fidaneve të arres nga BE" e lidhur me dt.04.12.2020 në vlerë prej 17.000.00 euro,*** *pra objekt i kontratës nuk është ngritja e pemishtes me arrë apo fidane por është kontratë e furnizimit apo e shitëblerjes.*
Pas kërkesës së AK për sqarim OE i rekomanduar për kontratë e ndryshon kontratën dhe objekt i kontratës tani është "Ngritja e pemishtes me fidane të arrës në vlerë prej 17.000.00 euro e lidhur me dt.04.12.2020,ku vrehet qartë se vetëm objekti i kontratës ka ndryshu,tani shtrohet pyetja a kemi të bëjmë me një kontratë apo janë dy kontrata të ndryshme....

Po ashtu ndryshimi është edhe tek referencat ku OE "Agrium"me qëllim të plotësimit të kërkesës për sqarim, referencën e lëshuar të dt.20.12.2018 e cila ishte për furnizim e ndryshon dhe e plotëson dhe e shton: "dhe përfundoi punën për mbjelljen e fidaneve kompanisë tonë.....".
Nga këto vrehet se i njejti ka dorëzuar dy dokumente prej të cilave sigurisht se janë të modifikuara dhe njëra me tjetrën ndryshojn me provat e dorëzuara gjatë ofertimit..

Provë:Kontratat e lartë cekuar dhe referencat për këto kontrata.

Po ashtu edhe për pretendimet tona në kërkesën për ri-shqyrtim kemi kërkuar nga AK që me rastin e ri-shqyrtimit të vërtetoj pretendimet tona se qëndrojn apo nuk qëndrojnë për qështjet që ne kemi ngritur kjo ka të bëjë edhe për tri projekte për të cilat OE i rekomanduar për kontratë edhe pa kërkesës së AK nuk ka arritur të arsyetoj se janë dokumente valide dhe plotësojnë kërkesat e AK sipas DT dhe NJPK kjo ka të bëj me:
1.Ngritja e pemishtes me fidane te mjedres dhe mbjellja ; 12.000.00 euro
2.Ngritja e pemishtes me fidane te molles dhe pjeshkes ; 50.000.00 euro
3.Ngritja e pemishtes me fidane te arres ; 17.000.00 euro
4.Ngritja e pemishtes me fidanes te arres ; 18.750.00 euro,

Ne e njoftojm panelin shqyrtues me pretendimet tona ankimore të parashtruara në kërkesën për ri-shqyrtim dhe për të cilat AK në vendimin e saj fare nuk ka dhën përgjigje ashtu siq është i obliguar sipas nenit 108A të LPP-së por vetëm me një paragraf se kemi respektu nenin 1 të LPP-së pa dhën përgjigje dhe arsyetim të vendimit të saj.

Ne si OE kemi ofertuar në këtë aktivitet të prokurimit me qmim më të ulët,i përgjegjshëm dhe konkurues,ku AK nuk ka aplikuar dispozitat e nenit 72 ndaj nesh por edhe ndaj OE tjerë nëse ka pas paqartësi ashtu siq ka vepruar për OE të rekomanduar për konttratë me qka ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 të LPP.

Për më tepër shihë kërkesën për ri-shqyrtim:

Sqarim:

Llot 1: ECO FRUITS 127.991,50 euro
Llot 2: GOE; Agrium Sh.p.k & Agrorural 75546,30euro

Shuma totale e Llot 1 dhe Llot 2 127991.5+75546.30=203,537.80 euro

Qe eshte me cmim me te lire se kombinimi i shpallor fitues

Llot 1: GOE; Agrium Sh.p.k & Agrorural 115188,00 euro
Llot 2: GOE;Asim Thaqi B.I & M.P.Sh Fidanishtja 88597,20euro

Shuma totale e Llot 1 dhe Llot 115188.00 + 88597.20=203,715.20 euro,

Pra kombinimi i shperblyer me kontrat rrezullton me i shtrejt per AK, e qe eshte ne kundershtim me ligjin.
AK ne njoftimim per eliminim ka kerkuar :
Kërkes 1. Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt

e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera,minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se Për loto 1= 200.000,00 € Për loto 2 = 100.000,00 euro.
(referencat jan private dhe mungojn transaksionet bankare)

Kërkesa 3. OE duhet të ketë në pronësi ose posedim pajisjet teknike a. Traktor për punimin e tokës
Deshmit e kerkuara; dëshmija
a.b. pajisjet të cilat regjistrohen duhet të kenë libreza të regjistrimit të cilat duhet të kenë validitet, pajisjet tjera duhe të sjellë dëshmi mbi pronësinë e tyre ose dëshmi mbi marrjen në shfrytëzim të këtyre pajisjeve(mungon libreza e qarkullimit)

Ne dojen e tenderit eshte kerkuar :
1 Pasqyrat e qarkullimit financiare të kompanisë, të shoqëruar me qarkullimi financiar nga banka për tri vitet e shkuara apo deklaratat e tatimeve vjetore të dorzuara në Administratën Tatimore të Kosoves.

Te gjitha deshmit sipas kerkesave i kemi derguar ne oferten tone te cilat lehtas mundet te verifikohet ne platformen elektronike te e-prokurimit,pandaj nuk qendron ne asnje rrethan pretendimi se mungon qarkullimi apo dekleratat e tatimeve vjetore nga ATK.
Ne rast se ju nevojiten deshmi rreth transaksioneve bankare per te deshmuar vertetsin e kontratave , ju si AK siq keni vepruar ne rastin e OE te shpallur fituese te tenderit eshte dashur qe sipas ligjit te kerkohet edhe nga ne si OE qarkullimi detal financiar.

Te kerkesat per pajisjet teknike kemi sjellur deshmit sipas kerkeses tuaj si AK, pra kontraten per blerje dhe DUD -in doganor qe deshmon pronesin e pajisjeve sipas kerkeses tuaj si AK.

Nga letra standarde për eliminimin tonë vrehet qartë se AK-Komuna e Prizrenit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 72 sepse me rastin e vlersimit të ofertave ka qenë i detyruar që të aplikoj nenit 72 dhe të kërkoj sqarime apo informacione lidhur me qarkullimin dhe paisjet e kërkuar,kjo mënyr e komunikimit ka vlejtë vetëm për OE të rekomanduar për kontratë me qka bie ndesh me nenit 7 sepse ka favorizuar një OE të caktuar.
Dispozitat e nenit 72 e detyrojnë AK që në momentin e aplikimit të këtij neni për një OE ai duhet të aplikohet edhe për OE tjerë.
Po ashtu në DT dhe në NJPK nuk është kërkuar që për kontratat dhe referencat nga sektori privat OE duhet të dorëzojnë edhe tranzakcionet bankare,AK nëse ka pas dyshime ka mund të kërkoj nga ne që të prezentojmë këto tranzakcione bankare por i njejti nuk ka kërkuar dhe eliminimi nga ky aktivitet i prokurimit është në kundërshtim me nenin 7 dhe 56.3 të LPP sepse nuk mund të eliminohet një OE për diqka që nuk ka qenë i kërkuar në DT dhe NJPK.
Lidhur me paisjet teknike ne kemi dorëzuar dëshmi ashtu siq është kërkuar në DT dhe NJPK,nuk qëndron pretendimi i juaj se ne nuk kemi dorëzuar librezën e qarkullimit edhe ashtu po të jetë neni 39.8 i RUOPP e autorizon Ak që të këroj sqarime dhe plotsim të dokumentacionit nga neni 65 deri tek neni 69 i LPP-së.

Gjatë egzaminimit te tendereve , AK KK Prizren por edhe pasi është përfunduar vlersimi,nga OE i shpallur fituese jan kerkuar dokumentacione shtes.
Ne dosjen e tendereve eshte kerkuar :

Dëshmia 1 Lista e projekteve te natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE-(e skenuar nga origjinali) për dosien elektronike, , të deshmuara me referenca dhe kontrata

të cilat dëshmojnë vlerën e punëve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të punëve. Dëshmija 2 Në pikën a. diploma e menaxherit, dëshmi mbi përvojën në punë, dëshmi mbi menaxhimin e projekteve, kontrata e punës ose e bashkëpunimit me OE në fjalë. dëshmija a.b. pajisjet të cilat regjistrohen duhet të kenë libreza të regjistrimit të cilat duhet të kenë validitet, pajisjet tjera duhe të sjellë dëshmi mbi pronësinë e tyre ose dëshmi mbi marrjen në shfrytëzim të këtyre pajisjeve,

Lista e dorezuar e projekteve nga kompani e shpallur fituese nuk permban kontratat dhe referencat e te gjitha kontratave te cekura ne list.
Edhe pas kerkeses nga AK qe te deshmoj se posedon kontratat dhe referencat e listuara OE i rekomanduar përkontratë "Agrium Sh.p.k & Agrorural "nuk ka arritur që të dëshmoj se plotëson kërkesën e AK ,i jjeti ka dorëzuar një deklarat gjenerale që nuk specifikon dhe i përgjigjet kërkesave të DT dhe kërkesës së AK për sqarim:
Në letrën standarde për sqarim AK ka kërkuar nga OE i rekomanduar për kontratë të sqaroj se në DT dhe në NJPK është kërkuar:

Dëshmia 1 Lista e projekteve te natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skenuar nga origjinali) për dosien elektronike, , të deshmuara me referenca dhe kontrata të cilat dëshmojnë vlerën e punëve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të punëve.
Ne listen e projekteve qe keni dorezuar jan edhe keto projekte gje qe mungojn ne dosje;
1. Ngritja e pemishtes me fidane te mjedres dhe mbjellja ; 12.000.00 euro
2. Ngritja e pemishtes me fidane te molles dhe pjeshkes ; 50.000.00 euro
3. Ngritja e pemishtes me fidane te arres ; 17.000.00 euro
4.Ngritja e pemishtes me fidanes te arres ; 18.750.00 euro,

OE i shpallur fituese nuk ka arritur te ofroj deshmit e kerkuara nga AK dhe ate:
Deshmia sipas kerkeses ne piken:

1.Ngritja e pemishtes me fidane te mjedres dhe mbjellja ; 12.000.00 euro-*nuk e ka sjell referencen dhe kontraten*

2.Ngritja e pemishtes me fidane te molles dhe pjeshkes ; 50.000.00 euro-e ka sjell kontraten dhe referencen me vlere te ndryshuar nga vlera e paraqitur ne listen e paraqitur me ofert ne e-prokurim, pra vlera e re eshte 56.750.00 euro .

1. **Ngritja e pemishtes me fidane te arres ; 17.000.00 euro- dokumenti i dorrzuar me ofert rrespekivisht kontrata dhe referenca shihet qart qe eshte kontrate e furnizimit ne deshmin e risjell pas kerkeses AK, per qudi e njejta kontrat dhe refernce eshte e ndryshuar- fallcifikuar dhe si e tille duhet te treajtohet nga organet kompetente si dhe duhet te sqarohet edhe nga AK , se si ka mundur qe me nje dokument te till te falcifikuar lehtas te verifikuar, te shperblehet OE me kontrat.**

4. Ngritja e pemishtes me fidanes te arres ; 18.750.00 euro,-edhe pas kerkeses nuk ka arritur ta sjell as kontraten es referencen , pra kjo kontrat nuk duhet te perfillet.

Ne baze te listes te projekteve te dorezuara ne ofert OE të shpallur fituese, nuk ka

arrit te i ploteson kriterin e kerkuar nga AK edhe pas kerkeses per dokumentacione shtese, per projekte te ngjajshme me vler 200.000.00 euro, dhe ne kete rast ka sjellur list te re te projekteve ne te cilen figurojn kontrata te cilat ne asnje rrethane nuk kan egzistuar ne dosjen e dorezuar me ofert permes e-prokurimit.

Nga të gjeturat në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë vijmë në përfundim se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesat e DT dhe NJPK sepse i njejti nuk ka ofruar dëshmi se plotëson këto kërkesa edhe pas ftesës nga AK që të plotësoj me prova projektet e listës së kontratave.
Në DT dhe në NJPK është kërkuar që kontrtat dhe referencat të jenë të natyrës së kontatës që nënkupton ngrije të pemishteve(përfshin punim të tokës,mbjellje,sistem të ujitjes etj) dhe jo furnizim me pemë ashtu siq ka dorëzuar OE i rekomanduar për kontratë disa kontrat dhe referenca.

Në DT dhe në NJPK si kriter i dhënies së kontratës ka qenëtenderi i përgjegjshëm me qmim më të ulët ne kemi plotësuar këtë kriter dhe jemi OE i përgjegjshëm me qmim më të ulët.
Nga të cekurat më lartë gjejmë AK me rastin e velersimit të ofertave ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të LPP dhe atë:
AK me këtë ka vepruar në kundërshtim me nenin 7.6(v)dhe (vi) citat:" (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse."

Po ashtu edhe dispozitate nenit 56.3 e qartësojnë këtë qështje sepse nuk mund të vlersohet të eliminohet apo rekomandohet një OE për kontrat për një kërkes,kriter apo specifikim i cili nuk ka qenë kërkesë e DT dhe njoftimit për kontratë citat i kësaj dispozite:
" 3. Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave të negociuara, pas publikimit të njoftimit të kontratës, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohen nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".

Neni 59.4 poashtu e trajton dhe rregullon këtë qështje citat :" Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi nëfjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit....."

Po asht AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 1 të LPP citat" Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese,koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla".
AK po ashtu ka vepruar në kundërshtim me nenin 72 të LPP sepse i njejti nuk ka kërkuar saqarbime shtesë nga OE tjerë pjesmarrës në këtë aktivitet të prokurimit.
Nga veprimet e saja AK me rastin e ri-shqyrtimit të kërkesës sonë bie ndesh me nenin 108A të LPP sepse i njejti nuk jep përgjgje në pretendimet tona ankimore.

Andaj paneli shqyrtues me trastin e shqyrtimit të kësaj ankese lidhur me aktivitetin e prokurimit" Ngritja e pemishteve me arrë dhe lajthi në Komunen e Prizrenit"me nr.të prokurimit 622-20-2025-5-2-1.të marr këtë:

VENDIM

1.Aprovohet si e bazuar ankesa e OE "ECO FRUITS"SHPK, nga Podujeva lidhur me aktiviteti i prokurimit për tenderin: " ***Ngritja e pemishteve me arrë dhe lajthi në Komunen e Prizrenit****",numri i aktivitetit të prokurimit:* ***622-20-2025-5-2-1 të inicuar nga Komuna e Prizrenit.***
2.Anulohet njoftimi për dhenje te kontratës per aktivitetin e prokurimit: " ***Ngritja e pemishteve me arrë dhe lajthi në Komunen e Prizrenit****",numri i aktivitetit të prokurimit:* ***622-20-2025-5-2-1 dhe lëna ktheht në ri-vlerësim.***

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Ne konsiderojmë se dëmet materiale janë humbja e kontratës me të cilin pësojmë në aspektin financiar,
Shpenzimet e përgaditjesë së tenderit,
Sigurimi i tenderit,
Shpezimet e ankesës.
Largimi nga tregu që për ne paraqet dëm në prespektiv dhe imazh të kompanisë tonë
Fitimi i planifikuar për këtë tender

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

1. *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
2. *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
3. *Një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
4. *Një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
5. *Nje kopje te kontrates dhe references te dorezuar me rastin e aplikimit me kompanin "EOS"SHPK nga Gjilani*
6. *Nje kopje te kontrates dhe references te ndryshuar me rastin e plotsimit te kerkuar te dokumentevete kerkuara nga AK*
7. *Lista e projekteve e dorzuar me rastin e ofertimit ne platformen elektronike*
8. *Lista e projekteve e ndryshuar me rastin e derezimit te dokumenteve te kerkuara nga AK*